

AKTI I THEMELIMIT

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“InnoSpark Technologies Company” shpk

Suo Jiandong, i biri i Yujun Suo , i datelindjes 06-07-1997 , banues ne Lagjen Nr.13 Durrës shtetas Kinez i identifikuar me numer pasaporte EJ2948132 dhe ID. 1870460620, qe ne vijim do te quhet “Ortak”.

Sot me date 05-07-2024, vendosem te themelojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar “InnoSpark Technologies Company” shpk ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1.Objekti i shoqerise


1.1.Shoqeria ka kete objekt veprimtarie:

- Zhvillimi i softuerve: duke përfshirë projektimin, zhvillimin, shitjen dhe mirëmbajtjen e softuerve aplikativ, softuerve të sistemit dhe softuerve të integruar.
- Ndërtimi i faqes në internet: duke përfshirë dizajnimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe optimizimin e faqes në internet, duke ofruar një gamë të plotë zgjidhjesh për ndërtimin e faqeve të internetit.
- Shërbimet dhe konsulencat e teknologjisë kompjuterike: duke përfshirë integrimin e sistemeve kompjuterike , inxhinierinë e rrjeteve, dizajnimin dhe zhvillimin e sistemit të informacionit, mbështetjen dhe mirëmbajtjen teknike, konsulencën për menaxhimin e projekteve të IT, etj.
- Tregtia e importit dhe eksportit: duke përfshirë biznesin e importit dhe eksportit të produkteve elektronike, pajisjeve kompjuterike, produkteve softuerike dhe aksesoreve përkatës, si dhe agjencisë së biznesit të importit dhe eksportit të produkteve të tjera legale.
- Shërbimet e konsulencës financiare ndërkombëtare: ofrimi i kërkimit të tregut financiar ndërkombëtar, konsulencës për investime, analizave financiare, menaxhimit të rrezikut dhe shërbimeve të tjera të konsulencës financiare.

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj,

Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1. Ortaket e shoqerise vendosen qe shoqerine ta emertoje



“InnoSpark Technologies Company” shpk

2.2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne : Lagja 13 Plazh DURRES

Prane Belmondo Hotel , Apartamenti me numer pasurie 24/135/ND+2-13 ne zonen kadratral 8518.

2.3. Shoqeria mund te krijoj qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3. Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi

3.2. Me vendim te tyre Ortaket e shoqerise mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ne perputhje me ligjin

3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj .


4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijoj pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortake ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.

4.5. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj

4.6. Ortaket kane te drejte te beje propozime, si dhe emeroje e shkarkoje, administratorin ose administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel, apo likujdatoret.



Neni 5

Kohezgjatja

5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar eshte **100 000** (njqindmije) leke dhe eshte i ndare ne 1 kuote.

6.2. Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte :

Suo Yujun Suo Jiandong 1 kuote , me vlere 100 000 leke perkatesisht 100 % te kuotave te shoqerise.

Kreu IV

ORGANET E SHOQERISE

Neni 7

7.1. Vendimet ne Shoqeri merren nga Ortaket ne Asamblene e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise dhe ekspeti kontabel i autorizuar caktohen nga Ortaket e shoqerise .

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 8

8.1. Administrimi i shoqerise do te behet nga Administratori i saj z. **Suo Yujun Suo Jiandong** .

8.2. Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese) vjet me te drejte riperteritje ne perfundim te mandatit

Kreu VI

DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

9.1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria , mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore do t'i mbetet Ortakeve te shoqerise ne raportet e zoterimit te kuotave te kapitalit.

9.2. Ky Akt shtypet dh efirmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore . Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise .

ORTAKET E SHOQERISE “InnoSpark Technologies Company” shpk

Suo Jiandong

